

# PARIMET E ETIKËS DHE VEPRIMIT



PRINCIPLES  
OF CONDUCT  
AND ACTION

## PRINCIPLES OF CONDUCT



PROFESSIONAL  
COMMITMENT



RESPECT FOR  
OTHERS



INTEGRITY



LOYALTY



SOLIDARITY

## PRINCIPLES OF ACTION



CARING FOR HEALTH  
AND SAFETY



CARING FOR  
THE ENVIRONMENT



RESPECT  
FOR THE LAW



EMPLOYEE RIGHTS

## PARIMET E ETIKËS



**PERKUSHTIMI  
PROFESIONAL**



**RESPEKTI NDAJ  
TJETRIT**



**INTEGRITETI**



**BESNIKËRIA**



**SOLIDARITETI**



## PARIMET E VEPRIMIT



**KUJDESI PËR SHËNDETIN  
DHE SIGURINË**



**KUJDESI PËR  
MJEDISIN**



**RESPEKTIMI LIGJIT**



**TË DREJTAT E  
PUNËMARRËSIT**

The **Saint-Gobain** Group has developed a number of shared principles applied by both management and employees that have guided the Group's activities over the years.

Today the Group wishes to give written expression to these principles, to help us communicate them and reinforce their implementation throughout the Group worldwide.

The purpose of this document is also to make a public statement of **Saint-Gobain's** adherence to these basic principles of conduct and action, which apply to all companies within the Group regardless of where they carry on business.

These principles are not intended to be exhaustive, but to address the essential areas. They are complemented, and may in the future be further complemented by sometimes more specific rules having regard to local conditions or particular positions of responsibility, but in any case without detracting from the basic principles.

Adherence to these principles is a requirement for belonging to the **Saint-Gobain** Group.





Grupi **Saint-Gobain** ka zhvilluar një sërë parimesh të përbashkëta, të zbatueshme si për strukturat drejtuese ashtu edhe për punonjësit, që kanë udhëhequr aktivitetet e Grupit ndër vite.

Sot Grupi dëshiron t'i shprehë me shkrim këto parime, për të na ndihmuar t'i komunikojmë ato dhe për të përforcuar zbatimin e tyre në të gjithë Grupin në mbarë botën.

Qëllimi i këtij dokumenti është të shërbejë edhe si një deklaratë publike për respektimin nga **Saint-Gobain** të këtyre parimeve bazë të etikës dhe veprimit, të cilat zbatohen për të gjitha shoqëritë e Grupit, pavarësisht se ku e ushtrojnë aktivitetin.

Këto parime nuk synojnë të jenë shteruese, por të trajtojnë fushat thelbësore. Ato janë plotësuese dhe në të ardhmen mund të plotësohen më tej me rregulla edhe më specifike, duke pasur parasysh kushtet lokale ose pozitat specifike të përgjegjësisë, por në çdo rast pa devijuar nga parimet bazë.

Respektimi i këtyre parimeve është kusht për të qenë pjesë e Grupit **Saint-Gobain**.





## PRINCIPLES OF CONDUCT

The Saint-Gobain Group considers that the basic values shared by management and employees alike are: professional commitment, respect for others, integrity, loyalty, and solidarity.

These principles of conduct apply to each of us.

## PARIMET E ETIKËS

Grupi Saint-Gobain çmon se vlerat bazë që strukturat drejtuese dhe punonjësit ndajnë janë: përkushtimi profesional, respekti ndaj tjetrit, integriteti, besnikëria dhe solidariteti.

Këto parime të etikës vlejné për secilin prej nesh.



## Professional commitment

Means mobilizing to the best of one's ability the knowledge and know-how of the individual and also calls for training to keep both up to date. It requires personal commitment and a willingness to take on the tasks assigned and to acquire knowledge necessary to do the job. It implies the effective contribution of each person in caring particularly for the environment and for worker health and safety.



## Përkushtimi profesional

Do të thotë të mobilizosh maksimumin e aftësive, njohurive dhe ekspertizës së individit dhe kjo kërkon edhe trajnim për t'i mbajtur këto aftësi dhe njohuri të përditësuara.

Nevojitet përkushtim profesional dhe gatishmëri për të marrë përsipër detyrat e caktuara dhe për të përfutur njohuritë e nevojshme për të kryer punën. Kjo nënkupton kontributin efektiv të çdo personi veçanërisht në kujdesin ndaj mjedisit dhe shëndetit e sigurisë në punë.

PRINCIPLES  
OF CONDUCT

PARIMET  
E ETIKËS



## Respect for others

is an absolute prerequisite for the professional and personal development of each person. It applies throughout the Group worldwide. It implies an acceptance of pluralism and other cultures and of people of all origins. It is expressed in a readiness to listen to others, to inform, to explain, and to engage in dialogue.



## PRINCIPLES OF CONDUCT PARIMET E ETIKËS


## Respekti ndaj tjetrit

është parakusht thelbësor për të siguruar zhvillimin profesional dhe personal të çdo individi. Ky parim duhet të respektohet në të gjithë Grupin në mbarë botën. Presupozon pranimin e pluralizmit, të diversitetit kulturor dhe të të gjithë njerëzve pavarësisht nga origjina e tyre. Shprehet përmes gatishmërisë për të dëgjuar të tjerët, për t'i informuar, për të shpjeguar dhe për t'u përfshirë në dialog.

## Integrity

requires a rigorous adherence to probity in all professional activities. It means that no individual may compromise the interests of the Group entrusted to that individual in favor of his or her own private interests

– whether in dealing within the Group or in dealing on behalf of the Group with third parties, whatever local practices might be. Detailed rules of conduct may be adopted for certain categories of Group personnel where the nature of their responsibilities so requires.



## Integriteti

Integritet do të thotë ndjekja me vendosmëri e normave etike, të qenët i ndershëm në të gjitha aktivitetet profesionale. Mbi të gjitha, kjo do të thotë se asnjë individ nuk mund të komprometojë interesat e Grupit që i janë besuar atij individ në favor të interesave të tij/saj private, qoftë në marrëdhëniet brenda Grupit apo edhe kur vepron në emër të Grupit në marrëdhëniet me të tretë, pavarësisht nga praktikat vendase. Norma etike specifike mund të miratohen për kategori të caktuara punonjësish të Grupit, kur e kërkon natyra e përgjegjësiave të tyre.

## PRINCIPLES OF CONDUCT

## PARIMET E ETIKËS

## Loyalty

requires honesty and fairness in dealing with superiors, colleagues, subordinates and third parties dealing with the Group. In particular, it is incompatible with the pursuit of self-interest where the latter conflicts with the goals of the individual company or the Group as a whole. It implies the adherence to the guidelines and internal rules of individual companies and of the Group.



PRINCIPLES  
OF CONDUCT  
PARIMET  
E ETIKËS

## Besnikëria

do të thotë ndershmëri dhe drejtësi në marrëdhëniet me kolegët, eprorët, vartësit dhe palët e treta të lidhura me Grupin. Por sidomos ajo është e papajtueshme me ndjekjen e interesit vetjak kur ky i fundit bie ndesh me qëllimet e shoqërisë ose të Grupit në tërësi. Do të thotë, pajtueshmëri e plotë me udhëzimet dhe rregullat e brendshme të shoqërive individuale dhe të Grupit.

## Solidarity

is based on a sense of individual responsibility at work, which prevails over self-centered thinking. It encourages team work and bringing out the best in each person, in order to achieve the objectives

of the company and the Group. It means rejecting management or operational methods geared more to the self-satisfaction of given individuals rather than the interests of the individual company or the Group as a whole.



## Solidariteti

bazohet në ndjenjën e përgjegjësisë individuale në punë, që mbizotëron mbi të menduarit egocentrik. Promovon punën në grup dhe dhënien e kontributit më të mirë të mundshëm të çdo individi për të arritur objektivat e shoqërisë dhe të Grupit. Do të thotë, refuzim i metodave drejtuese ose operacionale të orientuara më shumë drejt vetëkënaqësisë së individëve të caktuar dhe jo drejt interesave të shoqërisë ose të Grupit në tërësi.

## PRINCIPLES OF CONDUCT

## PARIMET E ETIKËS



# PRINCIPLES OF ACTION

The Saint-Gobain Group wishes to set out the principles of action which govern the activities of all management teams and employees in the exercise of their professional responsibilities, regardless of the country involved. These principles of action<sup>(1)</sup> help us achieve responsible and sustainable growth, in accordance with the Group's long-term strategy.



## PÁRIMET E VEPRIMIT

Synimi i Grupit Saint-Gobain është të vendosë parime veprimi që do të rregullonin aktivitetet e të gjithë drejtuesve dhe punonjësve gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tyre profesionale, pavarësisht nga vendi në të cilin ata e kryejnë këtë punë. Këto parime të veprimi<sup>(1)</sup> kontribuojnë në arritjen e zhvillimit të përgjegjshëm dhe të qëndrueshëm, në përputhje me strategjinë afatgjatë të Grupit.

<sup>(1)</sup> They are intended to embody the OECD Guidelines for Multinational Enterprises, adopted in June 2000.

<sup>(1)</sup> Janë të harmonizuara me Udhëzimet e OECD-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe, të miratuara në qershor 2000.

## Respect for the law

All Group companies must apply in all areas all laws and regulations of the countries where they do business. Particular attention is drawn to the areas described below.

All Group companies must prohibit all actions which might breach applicable norms of competition law. They must refrain from any form of financing political parties or activities, even if allowed under local law. They must also reject all forms of active or passive corruption whether in domestic or international transactions<sup>[2]</sup>. Furthermore, Group companies must not exploit loopholes or inadequacies in any such laws or regulations where this would mean non-compliance with the norms of the Saint-Gobain Group in the areas described below.

<sup>[2]</sup> Covered by the OECD Convention on Combating Bribery of Foreign Public Officials in International Business Transactions of 17th December 1997.



## PRINCIPLES CONDUCT

PARIMET  
E ETIKËS

## Respektimi i ligjit

Të gjitha shoqëritë e Grupit duhet të respektojnë me përpikëri aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në shtetet ku ato ushtrojnë aktivitetin. Vëmendje e veçantë i kushtohet fushave të mëposhtme. Të gjitha shoqëritë e Grupit duhet të shmangin veçanërisht veprimet që mund të bien ndesh me rregullat e zbatueshme të ligjit të konkurrencës.

Në thelb, të mos përfshihen në asnjë formë financimi të partive politike apo veprimtarive politike, edhe nëse ligjet vendase e lejojnë këtë. Të refuzojnë çdo formë të korrupsionit aktiv ose pasiv, qoftë në transaksionet e brendshme apo edhe në ato ndërkombëtare<sup>[2]</sup>. Gjithashtu, shoqëritë e Grupit nuk duhet të shfrytëzojnë boshllëqet ose mangësitë në aktet ligjore ose nënligjore kur kjo do të nënkuptonte papajtueshmëri me normat e Grupit Saint-Gobain në fushat e përshkruara më poshtë.

<sup>[2]</sup> Referuar Konventës së OECD-së për Luftën kundër Korrupsionit në Administratën Publike në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit, datë 17 dhjetor 1997.



## Caring for the environment

Group companies are to actively promote the protection of the environment.

All company sites, wherever they are located, must be managed in a way that allows the setting of clear environmental

targets and the regular monitoring of environmental performances and measuring the same against these targets. They must strive to raise the main relevant environmental performance standards of their own sites to the level of particularly effective performance standards found in the Group for comparable sites – even if that means going beyond the requirements of local legislation.



## Kujdesi për mjedisin

Shoqëritë e Grupit duhet të promovojnë në mënyrë aktive mbrojtjen e mjedisit. Ambientet e shoqërisë, kudo ndodhen, duhet të menaxhohen përmes vendosjes së objektivave të qarta mjedisore, monitorimit të rregullt të performancave mjedisore dhe matjes së tyre kundrejt këtyre objektivave. Shoqëritë duhet të përpiqen të rrisin standardet kryesore përkatëse të performancës mjedisore në nivelin e standardeve efektive të performancës që hasen në Grup për zona të ngjashme – edhe nëse kjo do të thotë të shkosh përtej kërkesave të legjislacionit vendas.

## PRINCIPLES OF ACTION

## PARIMET E VEPRIMIT

## Worker health and safety

Group companies are to take particular care to adopt all measures necessary to ensure the best possible protection against health and safety risks in the workplace.

They must adopt risk reduction policies and follow-up on the due application of the same, checking actual results against the applicable standards. Such policies apply both to their own employees and to employees of subcontractors, when the latter are working on a Group site. They must strive to raise the main relevant health and safety performance standards of their own sites to the levels of particularly effective performance standards found in the Group for comparable sites – even if that means going beyond the requirements of local legislation.



## PRINCIPLES CONDUCT

## PARIMET E ETIKËS

### Shëndeti dhe siguria në punë

Shoqëritë e Grupit i kushtojnë vëmendje të veçantë miratimit të të gjitha masave të nevojshme për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.

Ato duhet të miratojnë politika për parandalimin e rrezikut dhe të mbikëqyrin zbatimin e tyre, duke ushtruar kontrole të gjendjes aktuale kundrejt standardeve në fuqi. Këto politika zbatohen si për punonjësit e vet shoqërisë ashtu dhe për punonjësit e nënkontraktorëve, nëse punojnë në objektet që i përkasin Grupit. Shoqëritë duhet të përpiqen të rrisin standardet kryesore përkatëse të performancës së shëndetit dhe sigurisë në nivelin e standardeve efektive të performancës që hasen në Grup për zona të ngjashme – edhe nëse kjo do të thotë të shkosh përtej kërkesave të legjislationit vendas.

## Employee rights

Group companies must scrupulously ensure that employees' rights are respected. They must promote an active dialogue with their employees. In addition, and without limitation, they must respect the following

rules, even if not provided for by applicable local law. They must refrain from any form of recourse to forced labor, compulsory labor, or child labor<sup>(3)</sup> – whether directly or indirectly or through subcontractors when the latter are working on a Group site; and they must refrain from any form of discrimination with respect to their employees, whether in the recruitment process, at hiring, or during or at the end of the employment relationship.

<sup>(3)</sup> As defined by the applicable Conventions of the International Labor Organization.

<sup>(3)</sup> Siç përcaktohet nga Konventat në fuqi të Organizatës Ndërkombëtare të Punës.



## Të drejtat e punëmarrësit

Shoqëritë e Grupit duhet të garantojnë respektimin me përpikëri të të drejtave të punëmarrësve. Ato duhet të promovojnë dialogun aktiv me punëmarrësit e tyre. Gjithashtu, duhet të respektojnë pa kufizim rregullat e mëposhtme, edhe nëse nuk kërkohet nga legjislacioni vendas: Shoqëritë e Grupit duhet të shmangin përdorimin e çdo forme të punës së detyruar dhe të pavullnetshme ose punës së fëmijëve<sup>(3)</sup>, drejtpërdrejt ose tërthorazi ose nëpërmjet nënkontraktorëve gjatë punës së tyre në objekte që i përkasin Grupit; si dhe duhet të shmangin çdo formë diskriminimi ndaj punëmarrësit, qoftë gjatë procesit të përzgjedhjes dhe marrjes në punë, ose gjatë marrëdhënies së punës apo gjatë procesit të zgjidhjes së marrëdhënies së punës.

PRINCIPLES  
OF ACTION

PARIMET  
E VEPRIMIT




People at every level in **the Saint-Gobain** Group are individually responsible for applying these principles of conduct and action. Each management level – company, business unit, Delegation or Sector, carries its own responsibility for ensuring that these principles are applied.

The Sectors and Delegations must report regularly to the general management of the Group on how these principles are being applied.

The general management of the Group will implement awareness and training programmes in order to promote these principles across the Group.

It will decide on appropriate methods to verify compliance.







Njerëzit në çdo nivel në Grupin Saint-Gobain janë individualisht përgjegjës për zbatimin e këtyre parimeve të etikës dhe veprimit. Çdo nivel drejtimi – shoqëri, njësi biznesi, delegacion apo sektor, mban përgjegjësinë e vet për të siguruar që këto parime të zbatohen.

Sektorët dhe delegacionet duhet t'i raportojnë rregullisht strukturës së lartë drejtuese të Grupit për mënyrën se si zbatohen këto parime.

Struktura e lartë drejtuese e Grupit do të zbatojë programe ndërgjegjësimi dhe trajnimi për të promovuar këto parime në të gjithë Grupin.

Kjo strukturë do të përcaktojë metodat e duhura për të verifikuar pajtueshmërinë.

## Glossary

### Organization for Economic Cooperation and Development – OECD

Founded in 1961 following on from the OEEC (Organization for European Economic Cooperation), the OECD's main vocation was to strengthen the economy of European countries. Today, the OECD groups 30 member countries worldwide, all sharing a commitment to democracy and the market economy. It has active relationships with some 70 other countries, NGOs and parliamentary institutions.

Its missions have been extended to support economic growth and boost employment, raise living standards, maintain financial stability, help other countries develop their economies and contribute to the growth of world trade, taking into account the key issues of globalization. Renowned for its publications and statistics, the OECD produces works covering the whole economic and social environment, from macroeconomics to trade exchanges, not forgetting education, development, science and innovation.

It also creates instruments adopted internationally, decisions and recommendations to promote new rules of the game where multilateral agreements are required to safeguard the progress of nations in a global economy.

### OECD Guidelines for Multinationals

The Guidelines form a set of non-restrictive recommendations to multinational businesses in all the major areas of corporate social responsibility, including employment and industrial relations, human rights, the environment, information disclosure, the fight against bribery and corruption, consumer interests, science and technology, competition, and taxation. Adhering governments are committed to promoting these guidelines vis-à-vis multinational enterprises operating in or from their territories. Although these are not mandatory provisions, it is worth noting the activities of National Contact Points (NCP),

i.e. government services in charge of promoting the Guidelines and conducting nationwide surveys. They can also be used as a mediation and conciliation platform should issues arise when the Guidelines are being implemented.





## Fjalorth

### Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik – OECD

E themeluar në vitin 1961 nën gjurmët e OEEC (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik Evropian), objektivi kryesor i OECD ishte forcimi i ekonomisë së vendeve evropiane. Sot, OECD grupon 30 vende anëtare në mbarë botën, të cilat ndajnë së bashku përkushtimin ndaj demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Ajo ka marrëdhënie aktive me rreth 70 vende të tjera, OJQ dhe institucione parlamentare.

Misionet e saj janë zgjeruar për të mbështetur rritjen ekonomike dhe për të nxitur punësimin, për të rritur standardet e jetesës, për të ruajtur stabilitetin financiar, për të ndihmuar vendet e tjera të zhvillojnë ekonomitë e tyre dhe për të kontribuar në rritjen e tregtisë botërore, duke marrë parasysh çështjet kryesore të globalizimit. E njohur për publikimet dhe statistikën e saj, OECD prodhon vepra që mbulojnë të gjithë mjedisin ekonomik dhe social, nga makroekonomia te shkëmbimet tregtare, duke mos harruar arsimin, zhvillimin, shkencën dhe inovacionin.

Ajo gjithashtu krijon instrumente të miratuara ndërkombëtarisht, vendime dhe rekomandime për të promovuar rregulla të reja loje ku kërkohen marrëveshje shumëpalëshe për të mbrojtur përparimin e kombeve në një ekonomi globale.

### Udhëzimet e OECD për Ndërmarrjet Shumëkombëshe

Udhëzimet formojnë një grup rekomandimesh jo kufizuese për bizneset shumëkombëshe në të gjitha fushat kryesore të përgjegjësisë sociale të korporatave, duke përfshirë punësimin dhe marrëdhëniet industriale, të drejtat e njeriut, mjedisin, dhënien e informacionit, luftën kundër rryshfetit dhe korrupsionit, interesat e konsumatorëve, shkencën dhe teknologjinë, konkurrencën dhe tatimet. Qeveritë aderuese janë të përkushtuara për të promovuar këto udhëzime kundrejt ndërmarrjeve shumëkombëshe që veprojnë në ose nga territoret e tyre. Edhe pse këto nuk janë dispozita të detyrueshme, vlen të theksohen aktivitetet e Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCP), pra, shërbimet qeveritare të ngarkuara për promovimin e Udhëzimeve dhe kryerjen e sondazheve në mbarë vendin. Ato mund të përdoren gjithashtu si një platformë ndërmjetësimi dhe pajtimi nëse lindin çështje gjatë zbatimit të udhëzimeve.

## OECD Convention dated December 17, 1997 on the fight against corrupting foreign public officials

This Convention asks adhering Governments to ensure that the corruption of foreign public officials, complicity and attempts to corrupt are considered criminal offences under their law. It defines corruption as being "the fact for any person intentionally to offer, promise or grant any undue benefit, pecuniary or otherwise, whether directly or through intermediaries, to a foreign public official, for his/her benefit or for the benefit of a third party, in return for the official acting or refraining from acting in compliance with the performance of official duties, in order to obtain or retain a market or other improper advantage in the conduct of international business."

In support of the Convention, additional recommendations in 2009 aimed to reinforce the fight against bribery. Good Practice Guidance on internal controls, ethics and compliance was adopted on 18<sup>th</sup> February 2010.

Adhering Governments have agreed to adopt new measures in order to redouble their efforts to prevent, detect and investigate transnational corruption by adopting a Recommendation designed to further combat bribery of foreign public officials in international business transactions.

## International Labor Organization – ILO

Founded in 1919 through the Treaty of Versailles, the ILO became in 1946 the United Nations' first specialized agency. It seeks to promote social justice and in particular have human rights recognized at the workplace.

The ILO formulates Conventions and Recommendations, setting minimum standards to be respected in terms of basic labor rights: freedom of association, the right to organize, collective bargaining, abolition of forced labor, equality of opportunity and treatment, etc.



[www.ilo.org](http://www.ilo.org)



## **Konventa e OECD, datë 17 dhjetor 1997, për Luftën ndaj Korrupsionit të Zyrtarëve Publikë**

Kjo Konventë u kërkon qeverive aderuese të garantojnë që korrupsioni i zyrtarëve publikë të huaj, bashkëpunimi dhe përpjekjet për të korrptuar të konsiderohen vepra penale sipas ligjit të tyre. Ajo e përkufizon korrupsionin si "situatë faktike ku çdo person qëllimisht ofron, premtan ose jep ndonjë përfitim të padrejtë, në para ose ndryshe, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësve, një zyrtari publik të huaj, për përfitimin e tij/saj ose për përfitimin e një të treti, në këmbim të veprimit ose mosveprimit të zyrtarit në përputhje me kryerjen e detyrave zyrtare, për të përfituar ose mbajtur një treg ose avantazh tjetër të pamërituar në ushtrimin e aktivitetit tregtar ndërkombëtar.

Në mbështetje të Konventës, rekomandimet shtesë në vitin 2009 synonin të përforconin luftën kundër korrupsionit. Udhëzimet e praktikave të mira për kontrollet e brendshme, etikën dhe pajtueshmërinë u miratuan më 18 shkurt 2010.

Qeveritë aderuese kanë rënë dakord të miratojnë masa të reja në mënyrë që të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar korrupsionin transkombëtar duke miratuar një Rekomandim të krijuar për të luftuar më tej korrupsionin e zyrtarëve publikë të huaj në transaksionet e aktivitetit tregtar ndërkombëtar.

## **Organizata Ndërkombëtare e Punës – ILO**

E themeluar në vitin 1919 përmes Traktatit të Versajës, ILO u bë në vitin 1946 agjencia e parë e specializuar e Kombeve të Bashkuara. Ajo synon të promovojë drejtësinë sociale dhe në veçanti të njohë të drejtat e njeriut në vendin e punës.

ILO formulon Konventa dhe Rekomandime, duke vendosur standarde minimale që duhen respektuar për sa i përket të drejtave themelore të punës, siç janë: liria e organizimit, e drejta për t'u organizuar, të drejtat për negociata kolektive, ndalimi i punës së detyruar, barazia e mundësive dhe trajtimit, etj.

## Conventions on fundamental labor rights

Adopted in 1998, the ILO Declaration on fundamental labor rights and principles groups conventions ensuring the promotion of fundamental values. These principles are notably:

### **Abolishing forced or compulsory labor**

According to the fundamental conventions of 1930 on forced labor (backed up by an additional protocol in 2014) and of 1957 on the abolition of forced labor (with an additional recommendation in 2014 involving further measures), the expression forced or compulsory labor means "any work or service which is exacted from any person under the threat of any form of punishment and for which the said person has not offered himself voluntarily." Today, there are still millions of victims of forced labor worldwide.

### **Abolishing child labor**

Child labor constitutes a violation of fundamental Human rights and it has been demonstrated that this impedes their development. The facts show that there is a direct link between household poverty and child labor and that sending children out to work perpetuates poverty by keeping them away from school and limiting their chances for social promotion. In this context, the ILO norms and standards on child labor constitute wide-reaching international legal instruments to fight against this scourge.

A 1973 convention sets the general minimum age for admission to employment or work at 15 (13 for light work) and the minimum age for hazardous work at 18 (16 under certain strict conditions). A second convention issued in 1999 aims to abolish the worst forms of labor for under-18s, especially all forms of slavery or practices similar to slavery, such as the sale or trafficking of children, debt bondage and serfdom, as well as forced or compulsory labor.

To this day, over 130 countries have ratified at least one of these 2 conventions.



## Konventat për të drejtat themelore të punës

Miratuar në vitin 1998, Deklarata e ILO-s mbi të drejtat dhe parimet themelore të punës grupon konventa që sigurojnë promovimin e vlerave themelore. Këto parime janë veçanërisht:

### Ndalimi i punës së detyruar

Sipas konventave themelore të vitit 1930 për punën e detyruar (të mbështetura nga një protokoll shtesë i vitit 2014) dhe të vitit 1957 për ndalimin e punës së detyruar (me një rekomandim shtesë në vitin 2014 që përfshin masa të mëtejshme), shprehja punë e detyruar ose e detyrueshme do të thotë "çdo punë ose shërbim që kërkohet nga çdo person nën kërcënimin e çfarëdo forme dënimi dhe për të cilën personi në fjalë nuk është ofruar vullnetarisht." Sot, ka ende miliona viktime të punës së detyruar në mbarë botën.

### Ndalimi i punës së fëmijëve

Puna e fëmijëve përbën shkelje të të drejtave themelore të njeriut dhe është dëshmuar se kjo pengon zhvillimin e tyre. Faktet tregojnë se ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë midis varfërisë së familjes dhe punës së fëmijëve dhe se dërgimi i fëmijëve në punë e përjetëson varfërinë duke i mbajtur ata larg shkollës dhe duke kufizuar shanset e tyre për promovim social. Në këtë kontekst, normat dhe standardet e ILO-s për punën e fëmijëve përbëjnë instrumente ligjore ndërkombëtare me shtrirje të gjerë për të luftuar kundër kësaj fatkeqësie.

Një konventë e vitit 1973 përcakton si moshë minimale të përgjithshme për pranim në punësim ose punë moshën 15 vjeç (13 vjeç për punë të lehta) dhe si moshë minimale për punë të rrezikshme moshën 18 vjeç (16 vjeç në kushte të caktuara strikte). Një konventë e dytë e nxjerrë në vitin 1999 synon të shfuqizojë format më të rënda të punës së fëmijëve nën moshën 18 vjeç, veçanërisht të gjitha format e skllavërisë apo praktikave të ngjashme me të, siç janë shitja dhe trafikimi i fëmijëve, lidhja nga borxhi dhe puna e detyruar dhe e sforcuar.

Deri më sot, mbi 130 vende kanë ratifikuar të paktën një nga këto 2 konventa.

## The International Bill of Human Rights

The International Bill of Human Rights consists of the Universal Declaration of Human Rights, the International Covenant on Economic, Social and Cultural Rights, the International Covenant on Civil and Political Rights and its two Optional Protocols.

### The Universal Declaration of Human Rights

Proclaimed as "a common standard of achievement for all peoples", it was adopted on 10<sup>th</sup> December 1948 by the General Assembly. Its 30 articles set forth the basic civil, cultural, economic, political and social rights that all human beings should enjoy in all countries. The provisions of the Universal Declaration of Human Rights are considered to have the status of rules of customary international law because they are so widely accepted and used as a yardstick for measuring the conduct of states.

### The International Covenants

After the Universal Declaration of Human Rights had been adopted, the Commission on Human Rights, the main intergovernmental body concerned with human rights within the United Nations, set to work to transform these principles into international covenants protecting specific rights. In view of the unprecedented nature of this task, the General Assembly decided to draft two Covenants covering the two types of rights identified in the Universal Declaration: civil and political rights, and economic, social and cultural rights.

When these two international Covenants came into force in 1976, many of the provisions of the Universal Declaration became obligatory for the states which had ratified them.

Together with the Universal Declaration and the Optional Protocols, these two International Covenants make up the Bill of Human Rights.



## **Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut**

Karta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut përbëhet nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe dy Protokolle opsionale.

### **Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut**

E shpallur si "një standard i përbashkët arritjesh për të gjithë popujt", ajo u miratua më 10 dhjetor 1948 nga Asambleja e Përgjithshme. 30 nenet e saj parashtrojnë të drejtat themelore civile, kulturore, ekonomike, politike dhe sociale që të gjitha qeniet njerëzore duhet të gëzojnë në të gjitha vendet. Dispozitat e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut konsiderohen se kanë statusin e rregullave të së drejtës zakonore ndërkombëtare, sepse ato janë të pranuara gjerësisht dhe përdoren si matës për matjen e sjelljes së shteteve.

### **Konventat Ndërkombëtare**

Pasi u miratua Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, organi kryesor ndërqeveritar që merret me të drejtat e njeriut pranë Organizatës së Kombeve të Bashkuara, filloi të punojë për t'i transformuar këto parime në pakte ndërkombëtare që mbrojnë të drejta specifike. Në funksion të natyrës së paprecedentë të kësaj detyre, Asambleja e Përgjithshme vendosi të hartojë dy Pakte që mbulojnë dy llojet e të drejtave të identifikuara në Deklaratën Universale: të drejtat civile dhe politike, dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Kur këto dy pakte ndërkombëtare hynë në fuqi në vitin 1976, shumë nga dispozitat e Deklaratës Universale u bënë të detyrueshme për shtetet që i kishin ratifikuar ato.

Së bashku me Deklaratën Universale dhe Protokollat Opsionale, këto dy Pakte Ndërkombëtare përbëjnë Kartën e të Drejtave të Njeriut.



## Global Compact

Saint-Gobain joined in 2003. Launched in July 2000 based on an idea from Kofi Annan, Secretary General of the United Nations, Global Compact is an international initiative involving more than 2000 companies, NGOs and civil society organizations (trade unions, schools, UN agencies, etc.) around ten universal principles in the areas of human rights, labor rights, the environment and the fight against corruption. Using this international network, the aim is to jointly contribute towards developing a humane and sustainable economy.

By joining Global Compact, Saint-Gobain undertakes to integrate the 10 principles in its strategy and operations.



## Kompakti Global

Saint-Gobain u bë pjesë e Kompaktit Global në vitin 2003.

I themeluar në korrik të vitit 2000 bazuar në një ide të Kofi Annan, Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kompakti Global është një iniciativë ndërkombëtare që përfshin më shumë se 2000 shoqëri tregtare, OJQ dhe organizata të shoqërisë civile (sindikata, shkolla, agjencitë e OKB-së, etj.) rreth dhjetë parimeve universale në fushat e të drejtave të njeriut, të drejtave të punës, mjedisit dhe luftës kundër korrupsionit. Duke përdorur këtë rrjet ndërkombëtar, synohet të kontribuojmë së bashku drejt zhvillimit të një ekonomie humane dhe të qëndrueshme.

Duke u bërë pjesë e Kompaktit Global, Saint-Gobain merr përsipër të integrojë 10 parimet në strategjinë dhe operacionet e tij.



Compagnie de Saint-Gobain  
Les Miroirs  
92096 La Défense Cedex  
France

Vydání: 08/2023